REPUBLIKA KOSOVO · REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIC OF KOSOVO
ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRACANICA
3090/24 25 JUN 2024

**OPŠTINA GRAČANICA**

*Gračanica, 25.06.2024.*

# Javni poziv za ponudu javne finansijske podrške za finansiranje projekta/programa NVO koji doprinose izgradnji kapaciteta mladih ljudi i dece sa područija opštine Gračanica

1. Opština Gračanica poziva sve nevladine organizacije (NVO) da konkurišu za finansijsku podršku za sprovođenje projekta koji imaju za cilj izgradnji kapaciteta mladih ljudi i dece sa područija opštine Gračanica, kroz različite aktivnosti omladinske politike, podsticanjem i razvijanjem omladinskih inicijativa, podsticanjem i usmeravanjem omladinske participacije u lokalnoj zajednici, kao i afirmacijom zdravih stilova života mladih sa ciljem pružanja kvalitetnog edukativno-informativnog sadržaja ali i unapređenja njihovih mogućnosti za zapošljavanje i samozapošljavanje. Na taj način, zajednica će biti ojačana kroz osnaživanje omladine, što će doprineti smanjenju migracije mladih ljudi iz Gračanice.

2. NVO u skladu sa ovim Javnim pozivom mogu da apliciraju sa projektima/programima za sledeće aktivnosti:

- **Kursevi**: Organizacija kurseva iz različitih oblasti, kao što su IT veštine, jezici, preduzetništvo, digitalni marketing i druge oblasti od značaja za mlade.
- **Treninzi**: Sprovođenje treninga za sticanje praktičnih veština, uključujući ali ne ograničavajući se na tehničke veštine, zanatske veštine, kao i meke veštine kao što su timski rad, komunikacija i liderstvo.
- **Seminari**: Organizacija seminara i radionica na različite teme koje su relevantne za razvoj omladine, uključujući karijerno savetovanje, inovacije, kreativnost i društvenu odgovornost.
- **Mentorski programi**: Implementacija mentorskih programa gde iskusni profesionalci pomažu mladima u razvoju karijere, pružajući im podršku i smernice.
- **Inovativni projekti**: Podsticanje mladih na razvijanje inovativnih ideja i projekata koji mogu doprineti lokalnoj zajednici i njihovom profesionalnom razvoju.
- **Boot kampovi**: Organizacija intenzivnih trening kampova koji se fokusiraju na razvoj specifičnih veština u kratkom vremenskom periodu.
- **Učenje o veštačkoj inteligenciji**: Kursevi i radionice koji obuhvataju osnove veštačke inteligencije i njenu primenu u savremenom svetu.
- **Zapošljavanje preko interneta**: Edukacija o mogućnostima i veštinama potrebnim za rad na daljinu, freelancing, i online preduzetništvo.
- **Neformalna edukacija za decu**: Organizacija letnjih kampova za decu koja uključuju edukativne i zabavne aktivnosti.
- **Socijalna podrška za decu iz ugroženih porodica**: Organizacija letnjih kampova za decu iz ugroženih porodica, gde bi se družili i učili na različite teme korisne za njihov razvoj.

- **Podrška small scale inicijativama**: Dodela simboličnih mini grantova za organizovanje akcija u opštini koje promovišu važnost investiranja u omladinu i razvojne kapacitete omladine i dece.
- **Poboljšanje komunikacije**: Aktivnosti koje imaju za cilj poboljšanje kvaliteta komunikacije između omladine, opštine i civilnog društva, uključujući organizaciju okruglih stolova, radionica i zajedničkih projekata.

**3.** NVO može da podnese samo jedan projekat, kojim će obuhvatiti i doprineti promovisanju aktivnosti propisane tačkom 2. ovog Javnog poziva.

**4.** Ukupna planirana vrednost Javnog poziva iznosi 80.000,00 (osamdesethiljada) evra.

Minimalni iznos finansijske podrške koji se može dodeliti za svaki individualni projekata iznosi 10.000,00 (desethiljada) evra, maksimalni iznos za jedan projekat iznosi 80.000,00 (osamdesethiljada) evra.

**5.** Krajnji rok za dostavu predloga je 15 radnih dana od dana objavljivanja Javnog poziva, odnosno datum početka je 26.06.2024.godine, a poslednji dan za predaju predloga je 16.07.2024.godine.

**6.** Pravo konkurisanja imaju NVO koje su registrovane u registru nevladnih organizacija R.Kosova, sa sedištem na teritoriji opštine Gračanica, i koje deluju i registrovane su najmanje dve godine pre dana objavljivanja Javnog poziva. NVO koja podnosi aplikaciju mora da podnese dokaz da ukoliko je bila korisnik finanansijskih sredstava od strane opštine Gračanica, da je ista opravdala dostavljanjem finanasijskog izveštaja.

Pre potpisivanja ugovora, NVO treba da dostave dokaze da odgovorna osoba u NVO i menadžer projekta nisu pod istragom za krivična dela, kao i dokaze da je NVO rešila sva otvorenja pitanja o plaćanju doprinosa i poreza koji su bili neplaćeni.

**7.** Predlozi se dostavljaju samo u okviru predviđenog formulara, koji se zajedno sa Uputstvom za aplikante, mogu preuzeti na internet stranici *opštine Gračanica- kk.rks-gov.net/gracanice* Kompletna dokumentacija treba da se dostavi poštom ili lično, na dole prikazanu adresu: *Opština Gračanica, ulica Cara Lazara bb, 10500 Gračanica*

Proces prihvatanja, otvaranja i razmatranja aplikacija, vrednovanje aplikacija, ugovaranje, resursi, vreme i način podnošenja žalbi, postupanje sa dokumentima i kalendar implementacije poziva su detaljno predstavljeni u Uputstvu za aplikante.
Razmatraće se samo predlozi koji su podneti u okviru roka za podnošenja aplikacija i forme koji su određeni Javnim pozivom.

**8.** Sva pitanja u vezi sa javnim pozivom možete razjasniti samo elektronskim putem, dostavom e-maila na adresu: opstinagracanica@gmail.com

(m.p.)

**Predsednica opštine**

Prof. dr Ljiljana Šubarić

**Odluku dostaviti:**
- Kabinetu predsednika opštine;
- Odeljenju za budžet i finansije;
- Odeljenju za opštu administraciju;
- Arhivi

ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRACANICA
3090/24 25 JUN 2024

# KOMUNA E GRAÇANICËS

*Graçanicë, 25.06.2024*

**Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve që kontribuojnë në ngritjen e kapaciteteve të të rinjve dhe fëmijëve nga territori i Komunës së Graçanicës**

1. Komuna e Graçanicës fton të gjitha organizatat joqeveritare (OJQ) që të aplikojnë për mbështetjen financiare për zbatimin e projekteve që kanë për qëllim ngritjen e kapaciteteve të të rinjve dhe fëmijëve nga territori i Komunës së Graçanicës, përmes aktiviteteve të ndryshme të politikave rinore, nxitjes dhe zhvillimit të iniciativave rinore, inkurajimit dhe drejtimit të pjesëmarrjes së të rinjve në komunitetin lokal, si dhe afirmimit të stileve të shëndetshme të jetesës së të rinjve me qëllim të ofrimit të përmbajtjeve cilësore edukativo-informuese, por edhe avancimit të mundësive të tyre për punësim dhe vetëpunësim. Në këtë mënyrë do të forcohet komuniteti përmes fuqizimit të të rinjve, gjë që do të kontribuojë në zvogëlimin e migrimit të të rinjve nga Graçanica.

2. OJQ-të në përputhje me këtë Thirrje publike mund të aplikojnë me projekte/programe për aktivitetet e mëposhtme:

- **Kurse**: Organizimi i kurseve nga fushat e ndryshme, siç janë: IT aftësia, gjuhët, sipërmarrja, marketingu dixhital dhe fushat e tjera me rëndësi për të rinjtë.
- **Trajnime**: Zbatimi i trajnime për të fituar aftësi praktike, duke përfshirë, por pa u kufizuar në aftësitë teknike, aftësitë artizanale, si dhe aftësitë e buta, siç janë: puna në grup, komunikimi dhe lidershipi.
- **Seminare**: Organizimi i seminareve dhe punëtorive për tema të ndryshme që kanë të bëjnë me zhvillimin e të rinjve, duke përfshirë këshillimin për karrierë, inovacionin, kreativitetin dhe përgjegjësinë sociale.
- **Programet e mentorimit:** Implementimi i programeve të mentorimit, ku profesionistët me përvojë i ndihmojnë të rinjtë në zhvillimin e karrierës së tyre, duke u ofruar atyre mbështetje dhe udhëzime.
- **Projektet inovative**: Inkurajimi i të rinjve për zhvillimin e ideve dhe projekteve inovative që mund të kontribuojnë në komunitetin lokal dhe zhvillimin e tyre profesional.
- **Boot kampe**: Organizimi i kampeve intensive të trajnimit që fokusohen në zhvillimin e aftësive specifike në një periudhë të shkurtër kohe.
- **Mësime rreth inteligjencës artificiale**: Kurse dhe punëtori që i përfshijnë bazat e inteligjencës artificiale dhe zbatimin e saj në botën moderne.
- **Punësimi përmes internetit:** Edukimi rreth mundësive dhe aftësive të nevojshme për punë në distancë, freelancing dhe sipërmarrje online.
- **Edukimi joformal për fëmijët:** Organizimi i kampeve verore për fëmijët që përfshijnë aktivitete edukative dhe argëtuese.

- **Mbështetja sociale për fëmijët e familjeve në nevojë:** Organizimi i kampeve verore në det për fëmijët e familjeve në nevojë, ku ata do të argëtohen dhe do të mësojnë për tema të ndryshme të dobishme për zhvillimin e tyre.
- **Mbështetja small scale për iniciativat:** Dhënia e mini-granteve simbolike për organizimin e aksioneve në komunë që promovojnë rëndësinë e investimit në të rinjtë dhe kapacitetet zhvillimore të të rinjve dhe fëmijëve.
- **Përmirësimi i komunikimit:** Aktivitetet që kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së komunikimit ndërmjet rinisë, komunës dhe shoqërisë civile, duke përfshirë organizimin e tryezave të rrumbullakëta, punëtorive dhe projekteve të përbashkëta.

**3.** OJQ-ja mund të paraqesë vetëm një projekt, me të cilin do të përfshijë dhe do të kontribuojnë në promovimin e aktiviteteve të parapara me pikën 2 të kësaj Thirrje publike.

**4.** Vlera e përgjithshme e planifikuar e Thirrjes publike është 80.000 (tetëdhjetë mijë) euro.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 10.000 (dhjetë mijë) euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 80.000 (tetëdhjetë mijë) euro.

**5.** Afati i fundit për dorëzimin e propozimit është 15 ditë pune nga dita e publikimit të Thirrjes publike, përkatësisht dita e fillimit është 26.06.2024, ndërsa dita e fundit për dorëzimin e propozimit është 16.07.2024.

**6.** Të drejten në aplikim e kanë OJQ-të të cilat janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare të Republikës së Kosovës, me seli në territorin e Komunës së Graçanicës dhe që veprojnë dhe janë të regjistruara së paku dy vjet para datës së publikimit të Thirrjes publike. OJQ-ja që dorëzon aplikacionin duhet të paraqesë dëshmi se nëse ka qenë përfituese e mjeteve financiare nga Komuna e Graçanicës, e njëjta i ka arsyetuar ato duke paraqitur një raport financiar.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-ja duhet të sigurojë prova që personi përgjegjës në OJQ-në/ menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova që OJQ-ja i ka zgjidhur të gjitha çështjet e pazgjidhura lidhur me pagesën e kontributeve dhe taksave të papaguara.

**7.** Propozimet do të dorëzohen vetëm në kuadër të formularit të paraparë, të cilin së bashku me Udhëzimet për aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të *Komunës së Graçanicës-kk.rks-gov.net/gracanice.* Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme: *Komuna e Graçanicës, rruga "Car Lazar" pn 10500 Graçanicë.*

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, resurset, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimin për aplikuesit.
Do të konsiderohen vetëm propozimet që janë paraqitur brenda afatit për paraqitjen e aplikacioneve dhe në formë të përcaktuar me Thirrjen publike.

**8.** Të gjitha pyetjet në lidhje me Thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: opstinagracanica@gmail.com.

(v.v.)

**Kryetarja e komunës**

Prof.dr Ljiljana Šubarić

**Vendimi i dorëzohet:**
- Kabinetit të kryetares së komunës;
- Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave;

- Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme;
- Arkivit.